

KOMPANIA REGIONALE E MBETURINAVE
“PASTËRTIA” SH.A.
N^r. 1494
FERIZAJ 29.03.2023

RAPORTI I PUNËS

2022



KRM “PASTËRTIA” SH.A.
FERIZAJ

Përbledhja

1.HYRJE	5
1.1 QËLLIMI I RAPORTIT	5
1.2 FUSHËVEPRIMTARIA E SHOQËRISË	5
2. FINANCAT	6
2.1 Klientët dhe kategoritë e tyre	7
2.2 Të hyrat	8
2.3 Inaksimi	9
2.4 Shpenzimet	11
3. OBLIGIMET	14
4. Shkalla e operimit	17
5. Gjendja e stoqeve	18
6. Të dhënat nga operativa	19
6.1 Deponitë ilegale	21
7. Administrata dhe burimet njerëzore	22
7.1 Raport nga zyra ligjore e KRM "Pastertia" Sh.A Ferizaj	22
7.2 Raport nga administrata dhe burimet njerëzore	22
7.3 Mbledhjet e bordit të drejtoreve të KRM "PASTERTIA"SH.A	24
7.4 Mbledhjet e anëtarëve të komisioneve komunale të KRM "PASTERTIA"SH.A.....	24

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Pasojat nga koha e shpalljes se pandemisë COVID-19 në vendin tonë kanë reflektuar në masë të madhe në kompaninë KRM “Pastërtia” Sh.A, sidomos në aspektin financiar. Shtuar këtu edhe krizën financiare në botë për shkakë të ndodhive të fundit që janë përcjellë.

Në kohën kur trendi i rritjes së vëllimit të mbeturinave në vendin tonë vazhdon të jetë në pjerrtësi konstante të rritjes, kompania ka pasur probleme dhe është ndier e dobët për sa i përket anës së makinerisë me të cilat kryhen shërbimet e grumbullimit dhe bartjes së mbeturinave. Mirëpo me ardhjen e makinerisë së re si donacion nga ana e KFW-së, GIZ-it dhe Qeverisë Japoneze, kompania ka marrë krahë dhe ka stabilizuar gjendjen e saj për sa i përket menaxhimit të grumbullimit dhe bartjes së mbeturinave në regjionin e saj Ferizaj, Shtime dhe Kaçanik. Defeketet e shumta të makinerisë që e kanë përcjellë kompaninë gjat viteve te kaluara kanë rritur shpenzimet për mirëmbajtjen e makinerisë dhe në raste tjera edhe kanë marrë kohë në sanimin e dëmeve të tyre. Në ndërkokë inkasimi i të hyrave nuk është rritur paralelisht me rritjen e shpenzimeve, gjë që ka ndikuar në rritjen e obligimeve ndaj furnitorëve, vështirësi në pagesë të pagave me kohë të puntorëve si dhe akumulimin e mjeteve rezervë për investime kapitale. E gjithë kjo gjendje kishte quar edhe në pakënaqësi nga ana e stafit punues në kompani por edhe nga ana e klientëve të cilëve ju kryhet shërbimi, për shkak të vonesave në kryerjen e shërbimeve të cilat kanë ndodhur shkaku i defekteve të makinerisë por edhe vëllimit të madhë të mbeturinave të cilat janë gjeneruar nga klientët tanë.

Për më tepër, për t'i dhënë shtysë negative këtij momentumi të KRM “Pastërtia” viteve të fundit, kompania e cila miret me menaxhimin e deponive të Kosovës, (KMDK), na krijonte probleme në shfrytëzimin e Qendrës së Transferit të mbeturinave në Gërlicë, ku nuk na lejohej zbranja e kamionëve, dhe kësijoj dërgimi i kamionëve për zbrasje në deponinë në Obiliq ishte problem në vete, gjë që na shkaktonte dëme në kohë dhe gjendjen funksionale të makinerisë për shkak të distancës dhe mundimit të makinerisë.

Duke hasur në këto vështirësi dhe presione, menaxhmenti i kompanisë është dashur të marrë disa vendime dhe shfrytëzime të rrugëve alternative për të qenë sa më korrekt në kryerjen e shërbimeve, kësijoj janë angazhuan makineri me qira si dhje një pjesë prej 6 fshatrave të Komunës së Ferizajt i janë dhënë për t'u kryer shërbimi një kompanie private me anë të një memorandum bashkëpunimi, por që të gjitha këto veprime kanë reflektuar edhe në shpenzimet financiare të kompanisë, por që kanë qenë dashur të ndërmirren këso veprimesh duke e ditur se vendi ende është në gjendje pandemie dhe se parandalimi i shfaqjes te ndonjë inkësioni nga ana e mbeturinave në vend ishte e domosdoshme.

Përkundër gjitha këtyre vështirësive, puna e KRM “Pastërtia” nuk është ndalur asnjëherë edhe përkundër se vëllimi i mbeturinave është rritur vazhdimisht edhe pse në vazhdim të raportit do të vërehet një ulje e sasisë së deponuar në një përqindje prej 2.19% apo shprehur në sasi 710 ton më pakë mbeturina të deponuara se në vitin paraprak, por që kjo ka ndodhur si pasojë e dhënjes për t'u kryer shërbimi një kompanie private me anë të një memorandum bashkëpunimi siç u përmend me lartë, por që nuk nënkupton se sasia e mbeturinave është zvogluar, përkundrazi ajo ështe rritur dhe vazhdon të rritet nga viti në vit.. Kësaj statistike i kontribon edhe numri i klientëve të cilët janë

shtuar në listën e shërbimeve të KRM “Pastërtia”, ku për dallim nga viti paraprak mbi 1000 mijë klientë janë regjistruar dhe janë shtuar në listën e faturimit ku shumicën dërmuese e përbënë klientët e amvisërisë, e që numri i klientëve që figurojnë në databazën e KRM “Pastërtia” në fund të vitit 2022 ishte 24,389 klientë. Sfidë në vete është edhe një numër i madh i ekonomive familjare të cilët duhet formalizuar dhe regjistruar pasi që ka edhe prej tyre që i janë shmangur kontraktimit për shërbimet të cilat ju kryhen.

Duke u bazuar në këto të dhëna dhe nga këta klientë, në vitin 2022 të hyrat e gjeneruara nga shërbimet e ofruara nga KRM “Pastërtia” janë 2,079,384.37 €, dhe nëse krahasojmë me vitin paraprak të hyrat e realizuara janë rritur për 24,086.30 euro, mirëpo sfida që e përcjellë KRM “Pastërtia” është vullneti qytetar për të kryer pagesat për shërbimet e pranuara kur nga këto të hyra dhe nga borxhet paraprake të klientëve janë arritur të inkasohen 1,943,260.53 €, e që marrë në krahasim nga viti paraprak në trend me rritjen e klientëve është rritur edhe vlera e mjeteve të inkasuara e që dallimi është për 5.63% apo në vlerë monetare prej 103,569.98 €

Në raport me të hyrat dhe inkasimin vie në shprehje edhe shpenzimet e realizuara gjat këtij viti, e që në vlerë monetare kapin shifren prej **2,110,661.23** €, që pjesën më të madhe të këtyre shpenzimeve e përbëjnë ato të pagave dhe meditjeve, shpenzimet për derivate, shpenzimet e deponisë, shpenzimet e mirëmbajtjes së makinerisë si dhe shpenzimet kontraktuale që shprehur në përqindje përfshijnë 93% të shpenzimeve të përgjithshme.

1.HYRJE

1.1 QËLLIMI I RAPORTIT

- 2 Bazuar në Ligjin për Ndërmarrje Publike, Ligjin për Shoqëri Tregtare, Ligjin për Mbeturina, Statutin e KRM “Pastërtia” Sh.A. si dhe rregullorën e punës së kompanisë lidhur me hartimin e raporteve të punës dhe rezultatet e arritura gjatë periudhave të caktuara kohore në vazhdim po e paraqesim raportin e punës për periudhën kohore Janar – Dhjetor 2022.
- 3 Qëllimi i këtij reporti është të sigurojë një bazë gjithëpërfshirëse të njojurive për menaxhimin e mbeturinave në KRM Pastertia. Të dhënat kryesore të ofruara në këtë report e jepin një ide të qartë për gjendjen, trendet dhe implikimet e tyre, si dhe planet e ardhshme.
- 4 Në vazhdim të raportit do të prezantohen në mënyrë të detajuar të gjitha të dhënat relevante të cilat janë të rëndësishme për të krijuar një pasqyrë të qartë për afarizmin e KRM “Pastërtia” Sh.A. Ferizaj.

1.2 FUSHËVEPRIMTARIA E SHOQËRISË

Fushveprimtaria e shoqërisë është e përcaktuar në bazë të licencës me të cilën disponon.

Veprimtaria e kësaj shoqërie aksionare ndahet në:

- a) Primare**
- b) Sekondare dhe**
- c) Veprimtari tjera**

1. **Veprimtaria Primare:** Grumbullimi i mbeturinave jo të rrezikshme, shërbimi i grumbullimit, largimit.
2. **Veprimtaria sekondare:** Aktivitetet e tjera të pastrimit, larja dhe spërkatja e rrugëve, mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëruara, mirëmbajtja e shërbimeve dimërore, bartja dhe groposja e shtazëve të ngordhura.
3. **Veprimtaritë tjera:** Trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave jot ë rrezikshme, rikuperimi i materialeve të klasikuara, tregtia me shumicë e mbeturinave dhe hekurishteve. Poashtu shoqëria mund të realizoj çdo lloj operacioni financiar apo tregtar i cili lidhet direkt ose indirekt me veprimtarinë e saj brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi si dhe mund të kryej çdo veprim me qëllim të marrjes së lejeve, autorizimeve, liçencave dhe miratimeve të nevojshme për realizimin e veprimtarive të saj për të cilat kërkoen këto dokumente administrative.

2. FINANCAT

Për të pasur një performancë të mirë dhe sukses në zhvillimin e aktivitetit të kompanisë, padyshim qëndrueshmëria financiare luan një rol shumë të rëndësishëm. Gjenerimi i të ardhurave dhe orientimi i kostos çojnë në një orientim të qartë të performancës së shërbimit si tërsi. KRM “Pastertia”, ka pasur probleme të mëdha me qëndrueshmërinë financiar në kohët e fundit, duke u nisur nga fakti se gjendja ekonomike edhe në botë është luhatur për shkakë të situatës së fundit të shkaktuar nga lufta ndërmjet shteteve të Rusisë dhe Ukrainës ku shumë produkte dhe lëndë të para që siguroheshin nga ky region patën efektin e tyre me rastin e shpalljes se sankasioneve dhe marrëdhënieve ndërkombëtare ndërmjet shteteve të mëdha, gjë që ka reflektuar edhe në ekonominë e vendit tonë dhe këtij problemi nuk i ka shpëtuar as KRM “Pastertia” Sh.A. Ferizaj.

Shkalla aktuale e arkëtimit nuk është e mjaftueshme për ta siguruar një qëndrueshmëri financiare të sistemit të menaxhimit të mbeturinave, si pasojë e borxheve të grumbulluara nga klientët të cilëve ju kryhet shërbimi i mbledhjes dhe bartjes së mbeturinave. Shkalla e arkëtimit është indikator i qartë i vullnetit për në këtë periudhë dhe mundësinë e klientëve për t'i paguar tarifat për shërbimet e mbledhjes së mbeturinave dhe/ose aftësisë së komunës për ta modernizuar dhe përmbaruar pagesën e tarifave. Ajo po ashtu e ofron një mundësi të shkëlqyer që komunat të reflektojnë për cilësinë e shërbimeve të mbledhjes së mbeturinave dhe, kësisoj, për t'i shtuar përpjekjet për arkëtim.

Më poshtë është ofruar një pasqyrë e shkallës së *Inkasimit, Të Hyrave, Kategorisë së Klientëve, Shpenzimeve për periudhën JANAR – DHJETOR 2022, gjendjës së Operativës dhe asaj të punëve Administrative*. Të dhënat janë ofruar nga sistemi intern i kontabilitetit dhe ai i faturimit dhe nga zyret përgjegjëse. Shumica e të dhënavëve janë ofruar si të dhëna të ndara për amvisëritë, bizneset dhe institucionet, duke evidentuar shumën e faturave të lëshuara dhe shumën e arkëtuar nga faturat e lëshuara.

Që KRM “Pastertia” të sigurojnë qëndrueshmëri financiare të sistemit të menaxhimit të mbeturinave, sugjerojmë se komuna duhet të vë në zbatueshmëri planin e ri të menaxhimit të mbeturinave komunale në mënyrë rigorozë dhe në këtë formë të krijoj një sistem efikas të arkëtimit.

Gjatë disa vjetëve të fundit, disa komuna kanë ndërmarrë reforma dhe veprime për ta ngritur shkallën e arkëtimit, si psh. komunat e Prizrenit, Prishtinës dhe Mitrovicës e kanë marrë përsipër arkëtimin nga KRM-të. Në këto raste tarifat janë bërë “taksë komunale”, duke e mundësuar kështu një zbatim më të lehtë, pra përmes kushtëzimit të shërbimit.

Përmbaruesi privat është një mekanizëm tjetër për mbledhjen e tarifave, gjë që është përdorur si rrugë e arkëtimit të të ardhurave nga ana e KRM “Pastertia” në disa raste, por që planifikohet edhe të realizohet edhe në të ardhmen, nëse klientët që kanë obligime të larta nuk reflektojnë në pagesën për shërbimet që ne si kompani ju ofrojmë.

Ne vazhdim të raportit do të prezantojmë të dhënat për:

- **Klientet dhe Kategoria e tyre**
- **Të Hyrat**
- **Inkasimi (arkëtimi)**
- **Shpenzimet**
- **Obligimet**
- **Llogarite e arketushme dhe**
- **Shkalla e performancës**

2.1 Klientët DHE KATEGORITË E TYRE

Bazuar në burime brenda kompanisë, vlerësohet se KRM “Pastërtia” Sh.A. Ferizaj operon në tri njësi komunale, në Ferizaj, Kaçanik dhe Shtime ku numri i banorëve të cilëve ju kryhet shërbimi arrinë shifrën rreth 93,400 banorë nga 178,071 mijë të vlerësuar nga Enti i Statistikave të Kosovës. Në databazën e KRM “Pastërtia” Sh.A. më 31.12.2021 listoheshin 23,138 klientë të faturuar apo aktiv, ndërsa më 31.12.2022 numri i klientëve të regjistruar arrinë shifrën prej 24,389 klient të faturuar apo aktiv.

Janar – Dhjetor	Klient aktiv – të faturuar
2021	23,138
2022	24,389
Rritje deri 30.12.2022	1,251

Analizuar sipas kategorive të klientëve të shërbyer në këtë vit ashtu si edhe në vitet paraprake numrin më të madh të klientëve e zënë kategoria e klientëve të shërbyer në amvisëri me 21,548 klient, biznese dhe industri 2,706 klient dhe institucionale 135 klient.

Po qe se e krahasojmë numrin e klientëve aktiv sipas kategorive të shërbyer në periudhën Janar-Dhjetor 2021 me atë të po të njejtës periudhë të vitit 2022 kemi një rritje te klientët e amvisërisë nga 20,525 klient në 21,548 klient që do të thotë, kemi rritje prej 4.98 %. Klientët e shërbyer në kategorinë e bizneseve dhe industriale prej 2,479 klientëve sa ishin në vitin 2021 në vitin 2022 evidentohen 2,706 klientë, nëse e paraqesim në përqindje do të thotë se kemi rritje prej 8.38%. Ndërkak tek institucionet kemi rritje solide prej 0.75% sepse nga 134 klient sa ishin në vitin 2021, në këtë periudhë raportimi numri i klientëve institucional të faturuar është 135.

Në mënyrë tabelare do të dukej kështu:

Nr.klientëve	2021	2022
Klientë në amvisëri	20,525	21,548
Klientë në bizn. dhe industri	2,479	2,706
Klientë Institucional	134	135

Në tabelën poshtë shënuar po ju paraqesim klientët aktiv sipas njësive për periudhën Janar-Dhjetor 2022;

Njësia	Amvisëri	Biznese të rregullta/ me kontratë	Institucionet	Gjithësej
Ferizaj	14,760	2,127	73	16,960
Kaçanik	3,654	279	35	3,968
Shtime	3,134	300	27	3,461
Gjithësej;	21,548	2,706	135	24,389

Bazuar në planin e biznesit, për vitin 2022 planifikimi për ekonomi familjare të shërbyera është 27,000 ndërsa klientët ekzistues të shërbyer në amvisëri ishte 21,548. Nëse e bëjmë krahasinmin në përqindje të realizimit të planit të biznesit atëherë vërejmë se kemi arritur të realizojmë 79.80 % të planifikimit. Për klientët në kategorinë e bizneseve planifikimi për 2022 ishte 3,200 klient, kurse në vitin 2022 në data bazën tonë figurojnë 2,706 klientë të shërbyer, kthyer në përqindje i bie që kemi arritur të realizojmë 84.56%

2.2 TË HYRAT

Bazuar në të dhënat kontabël për të hyrat e realizuara gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022 shofim se nga të hyrat e planifikuara në shumën prej 2,311,904.00 euro për vitin 2022, ne kemi arritur që të i realizojmë të hyrat në vlerë prej 2,079,384.37 euro, të hyra këto nga të gjitha kategoritë e klientëve.

Nëse do të krahasonim të hyrat e realizuara dhe të hyrat e planifikuara për periudhën e njejtë, pra për vitin 2022 kemi realizuar planin prej 89.94%.

Planifikimi i të hyrave dhe realizimi i planifikimit Janar – Dhjetor 2022.

Të hyrat Janar – Dhjetor 2022	Planifikimi	Realizimi
Të hyrat e faturuara	2,311,904.00	2,079,384.37

Në grafikun e paraqitur më lartë të hyrat paraqiten në total sipas planit dhe realizimit të tyre.

Të hyrat e realizuara për vitin 2021 ishin 2,055,298.07 € ndërsa të hyrat e realizuara në vitin 2022 janë 2,079,384.37 euro që do të thotë se të hyrat e realizuara në vitin 2022 janë më të larta për vlerën prej – 24,086.30 euro.

Tabela e të hyrave për periudhën Janar – Dhjetor për vitin 2021 dhe 2022

Të hyrat Janar- Dhjetor	Viti 2022	Viti 2021
Realizimi	2,079,384.37	2,055,298,07

Nëse i krahasojm të hyrat me donacione dhe subvencione kemi ulje të të hyrave prej 55,913.70 € për dallim nga viti paraprak ai 2021 ku KRM „Pastërtia“ Sh.A. nuk ka qenë përfituese e ndonjë subvencionari finanziar. Në vitin 2021 KRM „Pastërtia“ Sh.A Ferizaj ishte përfituese e një subvencionari në vlerë prej 80,000.00 € nga ana e Ministritës së Ekonomisë e ndarë në 4 periudha, si ndihmesë për mbulimin e shpenzimeve operative të derivateve dhe energjisë elektrike.

Tabela e të hyrave për periudhën Janar – Dhjetor për vitin 2021 dhe 2022 me donacione dhe subvencion

Të hyrat Janar- Dhjetor		Viti 2022	Viti 2021
Realizimi		2,079,384.37	2,055,298,07
Subvencione		0.00	80,000.00
Totali		2,079,384.37	2,135,298,07

Në vazhdim do të prezantohet tabela ku mund të shihet trendi i të hyrave në baza mujore përmuat Janar-Dhjetor 2022.

Të hyrat	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Të hyrat 2022	166,049	128,832	131,142	131,999	151,179	165,995	214,229	171,249	170,282	210,061	219,612	218,760
Të hyrat 2021	124,301	124,648	159,846	126,619	205,631	212,343	172,857	172,074	185,550	214,156	176,284	180,899

2.3 INAKSIMI

Në vitin 2022 ne kemi arritur që kërkesat tona ndaj klientëve të arrinin vlerën e faturuar prej 2,079,384.37 eurove, ndërsa inkasimin e këtyre kërkesave arritëm ta realizojmë në shumë prej 1,943,260.53 euro apo shprehur në përqindje kjo është 93.45% e kërkesave të realizuara. Në krahasim me vitin paraprak Inkasimi është më i lartë për 4.8%, ose thënë më ndryshe kemi rritje të inkasimit nga 88.65% sa ishte në vitin e kaluar nga raporti të hyra/inkasim në 93.45%.

Kërkesat	Kërkesat me tvsh (euro)	Inkasimi me tvsh (euro)
Viti 2021	2,075,298.07	1,839,690.55
Viti 2022	2,079,384.37	1,943,260.53

Të dhënat e lartëparaqitura janë përbledhje e të gjitha njësive operative dhe të gjitha kategorive të klientëve.

Në vazhdim po e paraqesim inkasimin e mjeteve për vitin 2021 sipas njësive operative. Shumat e dhëna janë me TVSH dhe ate sipas kategorive të klientëve.

Tabela e inkasimit për njësit operative:

Kategorit e klientëve Ferizaj	Ferizaj	Shtime	Kaçanik
Amvisëritë	729,516.24	139,461.464	182,781.98
Biznesi i rregullt – faturimi me tarifa	164,248.69	24,914.83	22,009.39
Biznesi me kontrata	98,038.87	15,955.02	22,519.75
Institucionet	436,351.98	61,968.04	45,494.28
Gjithësejt	1,428,155.78	242,299.35	272,805.40

Nga të dhënat e tabelës më sipër mund të konkludojmë se sa mjetet janë inkasuar në amvisëri biznese të rregullta, biznese me kontrata si dhe ato të institucioneve publike. Shtylla e parë e tabelës tregon inkasimin në Njësinë Operative Ferizaj, e dyta tregon inkasimin në Njësinë Operative në Shtime dhe e treta inkasimin në Njësinë Operativa në Kaçanik, tek të gjitha kategoritë e inkasimit me TVSH.

Nëse marrim në grafik të përqindjes na del se Njësia e Ferizajt është participuese me 73.49% të mjeteve të inkasuara, Njësia Kaçanik me 14.04% dhe Njësia e Shtimes me 12.47%.

Se çfarë rrjedhe - inkasim të mjeteve kemi pasur nga muaji Janar e deri në muajin Dhjetor për të dy vitet do të shofim në tabelën e ardhshme.

Muaji	Inkasimi 2022	Inkasimi 2021	Ndryshimi	Përqindja
Janar	115,055.21	101,426.89	13,628.32	13.44%
Shkurt	123,450.73	179,569.49	(56,118.76)	(31.25)%
Mars	259,193.94	149,072.36	110,121.58	73.87%
Prill	144,529.48	144,963.58	(434.10)	(0.30)%
Maj	123,359.40	158,807.32	(35,447.92)	(22.32)%
Qershor	119,703.21	133,274.55	(13,571.34)	(10.18)%
Korrik	206,322.06	230,001.37	(23,679.31)	(10.30)%
Gusht	182,167.34	176,246.16	5,921.18	3.36%
Shtator	126,558.72	114,609.65	11,494.07	10.43%
Tetor	217,815.59	112,830.52	104,985.07	93.05%
Nëntor	133,957.72	112,693.66	21,264.06	18.87%
Dhjetor	191,147.13	226,174.99	(35,027.86)	(15.49)%
Totali:	1,943,260.53	1,839,690.55	103,569.98	5.63%

Ndërsa nëse të njëjtin inkasim të mjeteve e paraqesim në tërsi 2022/2021, sipas kategorive të biznesit dhe ndryshimet në shumat e realizuara i paraqesim në përqindje me tvsh, atëherë të dhënat tabelare do të dukeshin kështu:

	Viti 2022	Viti 2021	Ndryshimi	%
Klientët me kontratë- Ferizaj	98,038.87	104,404.27	(6,365.40)	(6.1)%
Klientët me kontratë- Shtime	15,955.02	14,448.72	1,506.30	10.43%
Klientët me kontratë- Kaçanik	22,519.75	19,657.06	2,862.69	14.56%
Biznesi I rregullt Ferizaj	164,248.69	132,376.39	31,872.30	24.08%
Biznesi I rregullt Shtime	24,914.83	22,943.83	1,971.00	8.59%
Biznesi I rregullt Kaçanik	22,009.39	20,530.50	1,478.89	7.2%
Institucionet Ferizaj	436,351.98	476,196.23	(39,844.25)	(8.37)%
Institucionet Shtime	61,968.04	63,957.74	(1,989.70)	(3.11)%
Institucionet Kaçanik	45,494.28	35,841.29	9,652.99	26.93%
Amvisëritë Ferizaj	729,516.24	632,636.32	96,879.92	15.31%
Amvisëritë Shtime	139,461.46	131,834.97	7,626.49	5.78%
Amvisëritë Kaçanik	182,781.98	184,863.22	(2,081.24)	(1.13)%
Gjithsej:	1,943,260.53	1,839,690.55	103,569.98	5.63%

Nga databaza e kompanisë sipas të dhënave nga departamenti i shitjes, ku forma e inkasimit realizohet përmes 3 burimeve kryesore, asaj të Arkave, Bankave dhe përmes Inkasantëve në teren, vlenë të theksohet se forma e pagesave nga këto burimeve është si vijon:

***Arka** ka arritur të inkasoj **487,450.24 €** apo shprehur në përqindje **25.08%** të inkasimit të përgjithshëm

***Banka** ka arritur të inkasoj **618,776.17 €** apo shprehur në përqindje **31.84%** të inkasimit të përgjithshëm

***Inkasantët** kanë arritur të inaksojnë **837,034.12 €** apo shprehur në përiqndje **43.07%** të inkasimit të përgjithshëm

2.4 SHPENZIMET

Bazuar në të dhënat kontabile kompania në periudhen e vitit 2022 ka realizuar vlerën e shpenzimeve në shumën prej **2,110,661.33 euro**. Këtu përfshihen të gjitha shpenzimet e realizuara, përveq shpenzimeve të Amortizimit dhe Borxheve te Kqija, pasi që në kontabilitet ato nuk njihen si shpenzime.

Meqenëse koncepti sistemor i kontabilitetit tek KRM ” Pastërtia” Sh.A. është i rregulluar në atë mënyrë që shpenzimet i përpunon në tërsi, pra vetëm sipas kategorive të shpenzimeve, ne në këtë raport po i paraqesim shpenzimet në tërsi, të ndara sipas zërave që zënë përqindjen më të madhe të shpenzimve të përgjithëshme dhe sipas njësive.

Shpenzimet sipas kategorive për vitin 2021/2022;

Përshkrimi	2022	2021	Ndryshimi	Përqindja
Blerje material të tjera (1)	19,585.12	23,463.66	-3,878.54	(16.53)%
Shpenzimet per Kryp		4,524.27	-4,524.27	N/A
Shpenzimet e derivat. Naftes (2)	235,970.75	152,379.10	83,591.65	54.86 %
Blerje objekte inventari	180.00		180.00	N/A
Shpenzimet e Higjenes dhe Byfesë	2,093.87	1,235.48	858.39	69.48 %
Shpenzimet e enegjis elektrike	5,373.18	5,814.35	-441.17	(7.59)%
Shpenzimet e ujit	474.66	816.70	-342.04	(41.88)%
Shpenzime per antarsi Pamkos	4,800.00	4,800.00	0.00	-
Shpenz.per mbrojtje ne pune (3)	300.00	13,387.54	-13,087.54	(97.76)%
Shpenzime per dru zjarri	6,698.69		6,698.69	N/A
Shpenzimet e qiras (4)	13,250.00	5,205.00	8,045.00	154.56%
Mirëmbajtje dhe riparime	86,284.35	131,107.42	-44,823.07	(34.19)%
Shpenzimet e autogomave F (5)	2,925.66	10,758.69	-7,833.03	(72.81)%
Kontrolli teknik i automjeteve (6)	3,097.46	843.22	2,254.24	267.34 %
Sigurime	30.00		30.00	N/A
Sigurime për automjete	9,654.47	8,227.32	1,427.15	17.35 %
Taksë Administrative	4,803.75	550.00	4,253.75	773.41 %
Taksa rrugore	2,428.00	1,790.00	638.00	35.64 %
Taksa ekologjike	808.00	590.50	217.50	36.83 %
Taksa komunale	571.00	178.00	393.00	220.79 %
Shërbime kontraktuale (7)	56,783.30	34,186.79	22,596.51	66.10 %
Shpenz.per deponi KMDK	207,507.17	203,440.00	4,067.17	2.00 %
Shpenz. deponisë për mbetje shtazore qelq (8)		69,302.25	-69,302.25	N/A
Shpenzimet e Administrates	5,397.41	8,919.03	-3,521.62	(39.48)%
Shpenzimet per web faqe dhe reklama	1,491.60	1,041.09	450.51	43.27 %
Transferime, udhëtime, reprezentacion	2,422.91	3,960.89	-1,537.98	(38.83) %
Shpenzimet internet dhe telefon	7,946.07	9,313.60	-1367.53	(14.70) %
Shpenzime transporti		703.39	-703.39	N/A
Provizon bankar (9)	9,858.89	764.00	9,094.89	1,190.43 %
Taksa, tarifa, doganore		149.00	-149.00	N/A
Taksa e regjistrimit	185.00	570.00	-385.00	(67.54) %
Tatime tjera	4.24		4.24	N/A
Tatimi ne prone	423.07	1,328.27	-905.20	(68.15) %
Shpenzimet per paga	1,323,522.40	1,242,675.80	80,846.60	6.51 %
Shpenzimet per kontribut punedhens	66,176.12	62,039.34	4,136.78	6.67 %
Shpenzimet për përfaqësim	1,147.50	1,201.00	-53.50	(4.45) %
Gjoba dhe dëmshpérblime	2,478.22	972.17	1,506.05	154.92 %
Shpenzime financiare tjera	9,754.95	7,782.34	1,972.61	25.35 %
Shpenzimet e mirembajtjes se programit (10)	11,760.00	8,400.00	3,360.00	40.00 %
Ndihma solidare	3,561.00	4,335.10	-774.10	(17.86) %
Shpenzimet qe nuk i nje ATK	912.52		912.52	N/A
Total:	2,110,661.33	2,026,755.31	83,906.02	4.14 %

*Sqarime

- (1) Tek zëri “Blerje material të tjera” përfshihen shpenzimet të cilat kanë të bëjnë me furnizime me produkte për nevoja kryesishët të punitive të operativës, (sprej për saldim, shampoo, CO₂, pajisje për mekanikët, tonera për printer, etj.)
- (2) Zëri “Shpenzimet e derivat. Naftes” ka shënuar rritje për arsyet e rritjes së çmimit së derivateve të naftës pothuajse 100%.
- (3) Tek zëri “Shpenzime për mbrotje në punë” vlera është me ulët për arsyet në vitin 2021 kemi hapur tender përfshihen me veshmbathje dhe pajisje pune për punitivët e operativës, ndërsa në vitin 2022 nuk ka pasur nevojë për këtë lloj tenderi.
- (4) Shpenzimet e qiras përfshihen shpenzimet e qirasë janë njohur si shpenzime në kohën kur është bërë pagesa e tyre, kësisoj disa pagesa të qirasë përfshihen me veshmbathje dhe pajisje pune përfshihen me veshmbathje e pagesave të qirasë përfshihen me veshmbathje e pagesave të qirasë. Ndërsa gjatë vitit 2022, shpenzimet e qirasë janë rexhistruar çdo muaj në librat kontabël.
- (5) Shpenzimet e autogomave janë më të ulta në vitin 2022 përfshihen shpenzimet e qirasë janë njohur si shpenzime në kohën kur është bërë pagesa e tyre, kësisoj disa pagesa të qirasë përfshihen me veshmbathje dhe pajisje pune përfshihen me veshmbathje e pagesave të qirasë. Ndërsa gjatë vitit 2022, shpenzimet e qirasë janë rexhistruar çdo muaj në librat kontabël.
- (6) Kontrolli teknik i automjeteve ka shënuar rritje të vlerës përfshihen shpenzimet e qirasë janë njohur si shpenzime në kohën kur është bërë pagesa e tyre, kësisoj disa pagesa të qirasë përfshihen me veshmbathje dhe pajisje pune përfshihen me veshmbathje e pagesave të qirasë. Ndërsa gjatë vitit 2022, shpenzimet e qirasë janë rexhistruar çdo muaj në librat kontabël.
- (7) Tek zëri “Shërbime Kontraktuale” kemi rritje të shpenzimeve si arsyet e marrëveshjes së bashkëpunimit që kemi pasë me kompaninë private MeA, e cila kishe marrë në shërbim grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave në gjashtë (6) fshatra të cilat janë në zonën e shërbimit të KRM “Pastërtia” Sh.A Ferizaj.
- (8) Tek zëri “Shpenz. deponisë përfshihen shpenzimet e qirasë janë njohur si shpenzime në kohën kur është bërë pagesa e tyre, kësisoj disa pagesa të qirasë përfshihen me veshmbathje dhe pajisje pune përfshihen me veshmbathje e pagesave të qirasë. Ndërsa gjatë vitit 2022 kemi pasë të kontraktuar një kompani private e cila mirrej me grumbullimin dhe bartjen e eshtrave dhe qelqit.
- (9) Zëri “Provizon bankar” ka shënuar rritje të madhe në dallim me vitin paraprak, sepse në vitin 2022 KRM “Pastërtia” Sh.A përmes një marrëveshje me operatorin banker Banka Ekonomike, i është mundësuar shfrytëzimi i një overdrafti në vlerë prej 100,000.00 € përfshihen shpenzimet e qirasë janë njohur si shpenzime në kohën kur është bërë pagesa e tyre, kësisoj disa pagesa të qirasë përfshihen me veshmbathje dhe pajisje pune përfshihen me veshmbathje e pagesave të qirasë. Ndërsa gjatë vitit 2022 kemi pasë të kontraktuar një kompani private e cila mirrej me grumbullimin dhe bartjen e eshtrave dhe qelqit.
- (10) Shpenzimet e mirëmbajtjes së programit Alpha Web, janë më të larta se në vitin 2021 përfshihen shpenzimet e qirasë janë njohur si shpenzime në kohën kur është bërë pagesa e tyre, kësisoj disa pagesa të qirasë përfshihen me veshmbathje dhe pajisje pune përfshihen me veshmbathje e pagesave të qirasë. Ndërsa gjatë vitit 2022 kemi pasë të kontraktuar një kompani private e cila mirrej me grumbullimin dhe bartjen e eshtrave dhe qelqit.

Kështu do të paraqesim shpenzimet sipas këtyre zërvave:

- Shpenzimet përfshihen shpenzimet e qirasë janë njohur si shpenzime në kohën kur është bërë pagesa e tyre, kësisoj disa pagesa të qirasë përfshihen me veshmbathje dhe pajisje pune përfshihen me veshmbathje e pagesave të qirasë.
- Shpenzimet përfshihen shpenzimet e qirasë janë njohur si shpenzime në kohën kur është bërë pagesa e tyre, kësisoj disa pagesa të qirasë përfshihen me veshmbathje dhe pajisje pune përfshihen me veshmbathje e pagesave të qirasë.
- Shpenzimet përfshihen shpenzimet e qirasë janë njohur si shpenzime në kohën kur është bërë pagesa e tyre, kësisoj disa pagesa të qirasë përfshihen me veshmbathje dhe pajisje pune përfshihen me veshmbathje e pagesave të qirasë.

- Shpenzimet për mirëmbajtje dhe
- Shpenzimet tjera të përbledhura

Për të pasur një pasqyrë më të qartë të rrjedhjes së tyre ato do të i paraqesim për periudhen 2021/2022.

Të shofim shpenzimet e kategorizura më lartë sipas dinamikës së tyre 2021 dhe 2022.

Tabela vijuese na shpjegon më qartë këtë trend.

Shpenzimet	Viti 2021	Viti 2022	Diferenca
Shpenzimet për paga	1,304,715.14	1,389,698.52	84,983.38
Shpenzimet për derivate	152,379.10	235,970.75	83,591.65
Shpenzimet e deponimit	272,742.25	207,507.17	(65,235.08)
Shpenzimet e mirëmbajtjes	131,107.42	86,284.35	(44,823.07)
Shpenzimet tjera të përbledhura	165,811.40	191,200.54	25,389.14
Gjithësej	2,026,755.31	2,110,661.33	83,906.02

3. OBLIGIMET

Në vazhdim të raportit do të paraqesim rrjedhën e borxheve. Këtë pozicion do ta trajtojmë në këto faza:

Gjendja e borxheve (**obligimeve**) më 31.12.2022 dhe 31.12.2021

Data	Gjendja 31.12.2022	Gjendja 31.12.2021
Detyrime tjera ndaj operatoreve	1,190,367.00	835,382.18

Siq shifet kemi rritje të obligimeve për 354,984.82 euro apo të shprehura në përqindje kemi rritje prej 42.50%

Salldo e borxheve 31.12.2021 = 835,382.18 €

Salldo e borxheve 31.12.2022 = 1,190,367.00 €

Borxhet që vlenë te cekën janë ato ndaj KMDK-së të cilat kapin vlerën prej 175,506.42, ndaj ATK-së që kapin vlerën prej 454,136.00, ndaj operatorit ekonomik përfurnizim me derivate Petrol Company në vlerë prej 76,796.87 dhe kështu me radhë.

Përmes tabelës në vijim do të shohim obligimet e kompanisë ndaj furnitorëve sipas emërtimit të tyre:

SITUACIONI I FURNITORËVE MË 31.12.2022			
Nr.	Emërtimi i furnitorit	Detyrimi	Pesha
1	Kompania per menaxhimin e deponive ne Kosove Sh.A (KMDK SH.A.)	175,506.42	27.52%
2	KUVENDI KOMUNAL DREJT.EK FERIZAJ	175,406.00	27.51%
3	PETROL COMPANY SHPK	76,796.87	12.04%
4	BOSCH -AUTO NTP FERIZAJ	44,572.80	6.99%
5	MBROJTJA E AMBIENTIT	32,853.16	5.15%
6	HIB Petrol SH.P.K.	21,365.38	3.35%
7	STARGRAF SHTYPSHKRONJA FERIZAJ	15,060.00	2.36%
8	PAMKOS OJQ PRISHTIN	10,972.00	1.72%
9	TELEKOMI SH.A. (VALA ID-150528053491)	10,368.47	1.63%
10	BALLKAN PETROLL-VAJRA FERIZAJ	10,097.36	1.58%
11	INTERGRAF SHTYPSHKRONJE FERIZAJ	9,073.20	1.42%
12	PRO-MIX NTP 600691431 FERIZAJ	7,986.30	1.25%
13	SHPEND BERISHA FERIZAJ	7,200.00	1.13%
14	NP.UraniCom	4,454.45	0.70%
15	URANI COMERC NP FERIZAJ	4,397.40	0.69%
16	Përmbarues Privat "Bardh B. Tasholli"	3,741.49	0.59%
17	KRUK BIFURKACIONI KRUK	3,535.87	0.55%
18	LLAB H SH.P.K.	2,750.00	0.43%
19	BUJAR BAJRAMI QIRAJA RR.N.BEKA-FE	1,650.00	0.26%
20	KOHA GROUP PRISHTIN	1,589.00	0.25%
21	SYRI I SHQIPONJES SHPK FERIZAJ	1,319.52	0.21%
22	Hysni Islami V.Gervalla Qera	1,125.00	0.18%
23	AUTOGOMA DPZ FERIZAJ	1,119.36	0.18%
24	IMB Soft Sh.P.K.	1,070.20	0.17%
25	AGROCOOP NTPSH KOPER	1,069.00	0.17%
26	KOMBINATI DRURIT FERIZAJ	910.00	0.14%
27	KIENZLE AUTOSERVIS FERIZAJ	811.00	0.13%
28	FABRIKA VEGLAVE NSH FERIZ	742.45	0.12%
29	GAMA ELECTRONICS NTP FERIZAJ	602.00	0.09%
30	SAFETE LIVOREKA KAQANIK	600.00	0.09%
31	INFOPRESS PRISHTIN	556.80	0.09%
32	MATOSHI NTSH NIKADIN-FERIZAJ	500.00	0.08%
33	RIDI MAGAZIN NTPSH FERIZAJ	499.26	0.08%
34	ADRIANI DPH FERIZAJ	470.20	0.07%
35	EPOKA E RE GAZETE PRISHTINE	432.00	0.07%
36	KUVENDI KOMUNAL SHTIME t SHTIME	423.07	0.07%
37	GENI AUTOSERVIS FERIZAJ	420.00	0.07%
38	DPH RESTORANT KRISTALI	413.82	0.06%
39	ZËRI GAZETE PRISHTIN	385.00	0.06%

40	MENTORI VULLKANIZER FERIZAJ	385.00	0.06%
41	RAMADAN AGUSHI K.B. KAQANIK	360.00	0.06%
42	DUKAGJINI K.SIGURIMIT PRISHTINE	353.80	0.06%
43	ITA NET NTP FERIZAJ	350.00	0.05%
44	RILINDJA COMERC LIBRARI FERIZAJ	343.55	0.05%
45	NTSH " TE KEPI"	342.50	0.05%
46	GOOL-DYER VULLKANIZER FERIZAJ	303.00	0.05%
47	DORIANA SHTYPSHKRONJA FERIZAJ	300.00	0.05%
48	ELEKTRO AM NTSH FERIZAJ	277.00	0.04%
49	APOLLONIA SHPK FERIZAJ	254.00	0.04%
50	KEDS	250.99	0.04%
51	AUTOKOM DPT FERIZAJ	249.80	0.04%
52	PIREVA NSHT PRISHTIN	247.70	0.04%
53	Dardha	246.53	0.04%
54	SHARR TREGTIA NPSHT KAQANIK	240.00	0.04%
55	SIGURIA KOMPANIA PRISHTINË	228.00	0.04%
56	UNIONI FINANCIAR SHPK PRISHTINE	213.97	0.03%
57	ALBI GOGA AUTOMEKANIK FERIZAJ	208.80	0.03%
58	MERMER KOMERC NPSHT BELINC-SHTIME	195.50	0.03%
59	PTK Prishtinë Ferizaj	191.16	0.03%
60	MUJA NTP F.DURAJ-KAQANIK	185.58	0.03%
61	IT SOLUTION NTSH FERIZAJ	180.00	0.03%
62	Elektrika Smart	176.00	0.03%
63	PASTRIMI NR PRISHTINË	172.50	0.03%
64	ALB AUDIT SHPK	158.40	0.02%
65	RAHOVICA COMMERCE SHPK	153.88	0.02%
66	PROTERMO NSH	132.55	0.02%
67	AKUMULATORI SH.P.K	129.45	0.02%
68	ELEKTROMETALI NTP R. BISL FERIZAJ	118.10	0.02%
69	ELSAM COMPANY TALINOC FERIZAJ	118.00	0.02%
70	ODA EKOMIKE E KOSOVES PRISHTINE	100.00	0.02%
71	BALL-KOS NT SUHAREK	100.00	0.02%
Gjithsej:		637,662.38	100.00%

Për sa i përket operatorve KDMK-së dhe Petrol Company tashmë kemi arritur një marrëveshje riprogramimi të borgjit dhe pagesen e tij me këste, ndërsa për borxhin ndaj ATK-së për shkak të obligimit të madhë që kemi, nuk kemi mundur të arrijmë marrëveshje për riprogramim të borgjit për shkak se fillimisht duhet të paguhet vlera prej 20% e borgjit për të hyrë në marrëveshje riprogramimi, vlerë kjo e cila për këtë periudhë është vështirë e arritshme që të paguhet nga ana e KRM “Pastërtia” duke e ditur se jemi duke u përballur me gjendje të vështirë financiare.

4. SHKALLA E OPERIMIT

Pas analizimit të hyrave dhe shpenzimeve, ne do të shikojmë performancen e domosdoshme për kompaninë.

1. Përforma e cila tregon shkallën e Operimit 1
2. Përforma e cila tregon shkallën e Operimit 2

Performanca e cila tregon shkallën e operimit 1 tregon mbulueshmërinë e shpenzimeve me të hyra për periudhën e caktuar.

1. Paraqitura tabelare e shkallës së operimit 1.

Të hyrat Janar – Dhjetor 2022	Shpenzimet Janar – Dhjetor 2022
2,079,384.37 €	2,110,661.33 €

Tabela më lartë tregon se shkalla e operimit 1 tregon se nuk kemi një përfomrim edhe aq të mirë, nëse e shprehim në përqindje atëherë kjo përqindje tregon se për 1.50 % kemi të hyra më të ulëta në raportë me shpenzimet e krijuara për periudhën 2022.

Njëra ndër përfomancat kryesore të kompanisë është shkalla e operimit 2 e cila tregon përqindjen e mbulimit të shpenzimeve me mjete të realizuara monetare për periudhën e caktuar kohore. Në rastin e kompanisë tonë kjo do shihet në tabelën vijuese. Raportin në mes mjeteve të inkasuara dhe mjeteve të realizuara për shpenzime për periudhën konkrete.

Të shofin tabelën e të dhënave.

Shpenzimet e realizuara Janar-Dhjetor 2022	Inkasimi i realizuar me tvsh. Janar - Dhjetor 2022
2,110,661.33 €	1,943,260.53 €

Bazuar në të dhënat e lartshënuara dhe grafikun e tyre shofim se shpenzimet e realizuara për këtë periudhë nuk janë mbuluar me mjete të inkasuara në tërësi, ku % e mos mbulueshmërisë së shpenzimeve nga inkasimi i realizuar është -8.60 %. Kjo do të thotë se përcjellja e aktivitetit ekonomik për këtë periudhë ishte negative pasi qe nuk kemi mbuleshmëri te shpenzimeve. Nga shkalla e realizimit të kësaj përfomance varet shumë afarizmi i suksesëshëm i kompanisë.

5. GJENDJA E STOQEVE

Emërtimi	Vendi	Saldo
TEB Bank	Feizaj	5,363.32
Banka për Biznes	Feizaj	34.83
ProCredit Bank	Feizaj	2,085.01
NLB	Ferizaj	278.78
Banka Ekonomike (1)	Ferizaj	-98,459.41
Banka Ekonomike (llog Kaçanik)	Kaçanik	1,687.15
Arka NR1(Qendrore)	Ferizaj	0.00
Arka NR2	Ferizaj	0.00
Arka NR3	Ferizaj	0.00
Arka NR4	Ferizaj	0.00
Arka Shtime	Shtime	244.25
Arka Kaçanik	Kaçanik	0.00

*Sqarim (1) vlera prej (-98,459.41) nënkupton shfrytëzimin e overdraftit për pagesën e pagave të puntorëve për muajin Dhjetor para përfundimit të vitit fiskal 2022.

Sa i përket gjendjes së stoqeve në fund te vitit jane paraqitur në tabelën e më poshtme

Nr	Përshkrimi	Njësia mat.	Sasia	Çmimi	Vlera
1	V.Motorrik 10-40	L	214	4.20	898.20
2	V.Motorrik 5-40	L	44	3.00	132.00
3	V.Motorrik 20-50	L	70	3.33	231.00
4	Vaj Hidroll-46	L	40	2.70	108.00
5	Vaj atef	L	120	3.00	360.00
6	Sea-90	L	80	2.70	216.00
7	Anti Friz	L	118	1.50	177.00
8	Shampon per Xhamra	L	12	1.00	12.00
9	Glicerin	L	13	4.00	52.00
10	Ad Bllue	L	260	0.80	208.00
11	Mast lubrifikues	kg	45	5.00	225.00
Totali					2,619.20

Nëse e krahësojmë gjendjen e stoqeve te vitit paraprak me ate te vitit aktual atehher tabela me poshte do të na e tregoj ate:

	Gjendja e stoqeve më 31.12.2022	Gjendja e stoqeve më 31.12.2021
Derivate të Naftës	0.00	4,452.43 €
Vajra motorike	1,945.20	1,918.96 €
Të tjera*	674.00	657.24 €
Total	2,619.20 €	7,028.63 €

6. TË DHËNAT NGA OPERATIVA

Bazuar në të dhënat e pranuara nga operativa me qëllim të përpilimit të raportit po i pasqyrojmë të dhënat për sasinë e mbeturinave të dërguara në Deponitë Gurëz, Gjilan dhe Prishtinë dhe atë sipas Njësive Operative.

Janar – Dhjetor 2022

Njësitë	Mbet. Gurëz	Mbet. Gjilan	Mbet. Prishtinë	Gjithësej Ton
Ferizaj	15,776.22	-	7,143.25	22,919.47
Shtime	-	-	4,709.59	4,709.59
Kaçanik	3,179.23	863.13	-	4,042.36
Gjithësej:	18,955.45	863.13	11,852.84	31,671.42

Janar – Dhjetor 2021

Njësitë	Mbet. Gurëz	Mbet. Gjilan	Mbet. Prishtinë	Gjithësej Ton
Ferizaj	17,261.32	-	6,215.12	23,476.44
Shtime	-	-	4,486.51	4,486.51
Kaçanik	2,982.72	1,436.88	-	4,418.88
Gjithësej:	20,244.04	1,436.88	10,701.63	32,381.83

Të dhënat mbi sasinë e grumbulluar të mbeturinave po qe se i kahasojmë për periudhën e njejtë për të dy vitet do të shofim se sasia totale e grumbulluar në vitin 2021 shprehur në tonelata ishte **32,381.83** ton, ndërsa në vitin 2022 kjo sasi ishte **31,671.42** ton. Sasia më e vogël e grumbulluar e mbeturinave në kahasim me e sasinë e grumbulluar në vitin 2021 prej **710.41** ton apo te shprehur në përqindje prej **2.19%**. Ky ndryshim vie si arsy qe ne nje periudhë kur KRM “Pastërtia” Sh.A. përballej me mungesë të makinerisë dhe dëmtime të shumta në atë ekzistuese, me anë të një memorandum bashkëpunimi një pjesë prej 6 fshatrave i ishte dhënë për të kryer shërbimin kompanisë private MeA, gjë që ka refelektuar edhe në sasinë e mbeturinave të deponuara nga ana e KRM “Pastërtia” Sh.A në deponitë e KMDK-së.

Nëse do të analizonim sasinë e mbeturinave të grumbulluar në bazë mujore atëherë do të kishim këtë gjendje të cilën po e paraqesim me anë të tabelës më poshtë.

Muajt	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Viti 2021	2,742	2,305	2,329	2,498	2,402	2,545	3,246	3,907	2,901	2,581	2,423	2,504
Viti 2022	2,471	2,150	2,380	2,376	2,521	2,451	3,093	3,791	2,953	2,634	2,516	2,335

Në tabelën më poshtë po e paraqesim një renditje më të detajuar për çdo muaj për sa i përket sasisë së mbeturinave të deponuara.

Nr.	Muaji	Ferizaj (ton)		Shtime (ton)		Kaçanik (ton)		Gjithsejtë (ton)	Nr. i zbrazjeve
		Gurëz	GL-PR	Gurëz	GL-PR	Gurëz	GL-PR		
1	Janar	1,695.10	9,46	-	433.11	308.78	24.90	2,471.36	694
2	Shkurt	1,533.80	7,20	-	322.02	266.90	19.96	2,149.88	737
3	Mars	1,715.10	7,80	-	357.62	287.10	12.05	2,379.67	893
4	Prill	1,697.72	12,28	-	362.06	279.30	24.52	2,375.88	806
5	Maj	1,783.90	6,98	-	389.06	320.80	20.62	2,521.36	897
6	Qershor	1,763.40	8,16	-	356.00	312.70	10.62	2,450.88	858
7	Korrik	1,826.70	416.50	-	407.64	348.10	94.48	3,093.42	863
8	Gusht	1,219.60	1,510.54	-	525.90	226.20	309.03	3,791.27	928
9	Shtator	733.90	1,403.34	-	428.52	271.30	115.77	2,952.83	952
10	Tetor	504.90	1,401.67	-	379.60	228.80	118.69	2,633.66	661
11	Nentor	626.30	1,171.51	-	369.94	299.90	48.40	2,516.05	646
12	Dhjetor	675.80	1,187.81	-	378.12	29.35	64.09	2,335.17	404
Gjithësejtë ton.		15,776.22	7,143.25	-	4,709.59	3,179.23	863.13	31,671.42	9,339
22,919.47					4,709.59		4,042.36		

Më poshtë në anë tabelare do të bëjmë prezantimin e makinerisë e cila ka vepruar dhe operuar nëpër trija njesitë e KRM “Pastërtia” Sh.A me të dhënat operative rrëth sasisë së derivateve të shpenzuara, sasisë së mbeturinave të deponuara dhe të dhënavë teknike të kësaj makinerie.

Pajisjet për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave të KRM “Pastërtia” Sh.A.

Brendi	Tipi	Kapaciteti	Viti i Prodhimit	Targat	Shpenzimet derivateve (L)	Sasia mbeturinave të deponuara (ton)
Iveco	Kamion	6 m ³	2011	05-972-FK	9,426.00	1,824.84
Iveco	Kamion	6 m ³	2011	05-973-FK	3,611.00	464.20
Mercedes	Kamion	14.6 m ³	1983	05-978-EB	8,300.00	1,898.50
MAN	Kamion	6.6 m ³	1990	05-267-CM	4,483.00	1,431.30
Iveco	Kamion	6 m ³	2001	05-249-AB	5,685.86	831.01
Iveco	Kamion	9 m ³	1980	05-472-FT	5,147.00	917.70
Mitsubishi	Kamion	4 m ³	2009	05-428-BH	6,063.00	1,489.60
Mitsubishi	Kamion	4 m ³	2009	05-348-BH	3,728.00	1,085.10
Ford	Kamionet	2.4 m ³	2003	05-611-EH	3,614.00	1,157.10
Mercedes	Kamion	15 m ³	1991	05-793-CK	7,206.00	958.56
MAN	Kamion	11 m ³	2006	05-438-FP	13,050.00	1,964.16
Mitsubishi	Kamion	4 m ³	2011	05-623-BL	4,545.00	1,335.72
Scania	Kamion	6.5 m ³	2006	05-399-FD	4752.48	683.014
Volvo	Kamion	7 m ³	2003	05-821-EP	3,224.57	664.80
Mercedes	Kamion	3.50 m ³	2004	05-819-EP	2,970.72	1,026.00

6.1 DEPONITË ILEGALE

Gjatë vitit 2022 me iniciative nga ana e Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencia të Ferizajt dhe të vetë KRM “Pastërtia” Sh.A Ferizaj janë bërë identifikime të deponive ilegale në teren, ku pas kësaj iniciative janë identifikuar deponi ilegale të mbeturinave të ndryshme si nga ato inerte, të vëllimshme dhe ato organike dhe të përziera.

Me angazhimet e bëra duke përdorur potencialin e KRM “Pastërtia” Sh.A përmes makinerive të saja dhe me angazhimin e një operatori ekonomik privat janë bërë mbledhja dhe bartja e disa nga këto deponi në qytetin e Ferizajt.

Ndër lokacionet të cilat janë eliminuar dhe pastruar nga deponitë ilegale vlejnë të cekën :

1. Fshati Varosh – janë larguar dy deponi ilegale
2. Rr. “Liman Reka” – janë larguar dy deponi ilegale
3. Rr. “Mic Sokoli”
4. Rr. “Sali Çeku” afër vorresave ortodokse
5. Rr. “Gjon Serreçi”
6. Rr. “Hysen Tërepza”
7. Rr. “Skenderbeu” afër shkollës filllore “Ahmet Hoxha”
8. Rr. “Bekim Osmani”
9. Rr. “Bajram e Gursel Sulejmani”
10. Fshati Lloshkobare
11. Fshati Fshat i Vjetër tek vorrezat e qytetit

Në total nga këto deponi janë larguar një sasi prej rreth 953.5 ton të mbeturinave.

7. ADMINISTRATA DHE BURIMET NJERËZORE

7.1 RAPORT NGA ZYRA LIGJORE E KRM "Pastertia" Sh.A Ferizaj

Gjate vitit 2022, pas evidentimit te nje numrit te madh te klienteve te cilet kane detyrimet ndaj KRM "Pastertia" Sh.A Ferizaj, me urdher te menagjementit me nje bashkepunim me Zyren e Klienteve dhe ate te faturimit pas mobilizimit te nje ekipe brenda Kompanise kemi shenuar verejte per te gjithe klientet te cilet detyrimet kane kaluar vleren mbi 100.00 Euro. Numri i vërejtjeve të dërguara për këta klient si paralajmërim për borxhin që kanë ndaj KRM "Pastertia" Sh.A ka kaluar vlerën në mbi 3,700 shkresa.

Pas ketyre verejteve, ne rastet kur klientet nuk kane reflektuar ndaj obligimeve te tyre kundrejt KRM "Pastertia" Sh.A Ferizaj, atehere kemi ndermarre edhe hapa te tjere per inkasimin e borxhit permes mekanizmave ligjor siç eshte permbaruesi privat.

Referuar mekanizmit te permbaruesit privat, atehere nga te dhenat e grumbulluara lendet jane proceduar si vijon:

Ne vitin 2022 janë dorëzuar gjithësejtë 90 lëndë të dërguara në procedura përmbarimore, nga këto lëndë 28 lëndë janë përfunduar tërësisht, 39 lëndë janë aktive dhe në procedurë, 8 lëndë janë përfunduar me marrëveshje riprogramimi nga ana e KRM "Pastertia" Sh.A dhe debitoret. Nga 90 lëndë, 6 prej tyre janë proceduar deri në bllokim të xhirologarive bankare. Gjat procedurave përmbarimore të ushtruara nga ana e KRM "Pastertia" Sh.A, 9 lëndë janë kundërshtuar nga palët dhe pritet të procedohet me anë të gjykatës.

7.2 RAPORT NGA ADMINISTRATA DHE BURIMET NJERËZORE

- Numri aktual i të punësuarve në fund të muajit Dhjetor 2021, ishte **275**. Në raport me vitin 2022, kemi pasur një rritje të theksuar në numrin e përgjithshëm të të punësuarve.
- Në fund të muajit Dhejtor 2022, KRM "Pastertia" Sh.A Ferizaj dhe dy (2) Njësitë – Shtime e Kaçanik ka të angazhuar gjithsej 287 të punësuar, përfshirë Aksionarët, Anëtaret e Bordit, Zyrtarët në Zyrë e Auditimit të Brendshëm, nivelin e lartë drejtues dhe personelin tjetër profesional dhe administrativ.
- Numri aktual i të punësuarve në fund të muajit Dhjetor 2022 me kontrat të rregullt është dyqind e gjashtëdhjetë e katër (264) punonjës, katër (4) nga të cilët janë në pushim pa pagesë
- Katër (4) punëtor janë në Asistencë Sociale me nga 50.00 euro.
- Nëntë (9) Aksionarë, katër (4) anëtarë të Bordit të Drejtorëve, një (1) Kryeshek Ekzekutiv, një (1) zv. Kryeshek Ekzekutiv, dy (2) Zyrtar në Zyrën e Auditimit, dy (2) Zyrtarë të Prokurimit.

- Gjatë vitit 2022 kemi pasur shtatë (7) ndërprejre të kontratave të punës dhe ate: një (1) pension, një (1) me rastin e vdekjes si dhe pesë (5) shkeputje të kontratave në mënyrë të njëanëshme.

Gjithashtu të dhënat janë paraqitur në tabelën në vijim:

			Bordi i Drejtoreve	4	Aksionar	9				
			Total	4	Total	9				
Zyra e Auditorit të Brendshëm	2		Kryeshef Ekzekutiv	1						13
Zyrtari i Prokurimit	2		Zv. Kryeshef Ekzekutiv	1						6
Total	4		Total	2						19
Menaxheri Regional i Operativës	1									
					Zyrtari Financiar	1				
Njësia Punuese Ferizaj	0	Njësia Punuese Kaçanik	Njësia Punuese Shtime		Menaxher i Shitjes	0	Sekretari i Kompanisë	1		
Përgjegjës i Njesis Ferizaj	1	Përgjegjës i Njesis Kaçanik	Përgjegjës i Njesis Shtime	1	zv. Menaxher i Shitjes	1	Menaxher Regional për Burime Njerzore	1		
Kontroll Tereni Regional	3	Kontroll Tereni	Kontroll Tereni	1	Shefi i Kontabilitetit	1	Zyrtari për Burime Njerzore	2		
Përgjegjës i Autoparkut	1	Vozitësit	Vozitësit	6	Financier - Kontist	2	Zyrtari Ligjor	1		
Vozitësit	33	Kryepunëtor	Kryepunëtor	1	Zyrtar për Planifikim-Analizë	1	P.i Z. për Klientë Ferizaj, Kaçanik dhe Shtime	0		
Mirembajtes i Konterjerëve	1	Punëtorët Fizik	Punëtorët Fizik	14	Certifikues	2	Zyrtarët për Klientë	7		
Kryepunëtor	1	Mekanikët	Mekanikët	1	Përgjegjësi i Faturimit	1	Arkiva	1		
Punëtorët Fizik	65				Faturistët	2	Menaxher i Zyres për Informim	1		
Përgjegjës i Punëtorisë	1				Përgjegjës i Arkave	1	Zyrtari për Informim	1		
Mekanikët	6				Arkatar	10	Përgjegjës i Rojtareve	2		
Zv. Përgjegjës i Njesis Ferizaj	0				Përgjegjësi i Inkasantëve	1	Sigurimi Ferizaj, Kaçanik dhe Shtime	18		
Zv. Përgjegjës i Autoparkut	1				Inkasantët	30	Asistente e KE-së	0		
Përgjegjës i Ndërrimit të natës	1				Referent i Mjeteve Themelore	1	Vozitës i KE-së	1		
					Depoistët, Furnizuesi	4	Pastrues Zyre Ferizaj, Kaçanik dhe Shtime	2		
							Punëtor Administrativ Kaçanik	1		
							Pushim pa pagesë	4		
							Asistencë Sociale	4		
Total	115	Total	24	Total	24	163	Total	58	Total	47
										268
										287

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor të vitit 2022, duke u bazuar në Ligjit të Punës Nr.03/L-212, Neni 8 dhe Udhëzimin Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik KRM "Pastërtia" Sh.A ka publikuar tre (3) konkurse të rregullta, për 21 Pozita: 2 – Mekanikë, 1 – Përgjegjës i Prokurimit, 1 – Menaxher i Shitjes, 1 – Zv. Menaxher i Shitjes, 1 – Burime Njerëzore, 1 – Arkatar, 3 – Vozitës, 9 – Punëtor Fizik, 1 – Kontroll Tereni, dhe 1 – Furnizues.

Gjithashtu, gjatë periudhë Janar - Dhjetor të vitit 2022, kemi publikuar edhe një (1) konkurs për pozitën e Zyrtarit të Lartë për Financa dhe Thesar

7.3 MBLEDHJET E BORDIT TË DREJTORËVE TË KRM “PASTËRTIA”SH.A

Gjatë vitit 2022, Bordi i Drejtorëve me Ekzekutivin e KRM “Pastërtia” Sh.A Ferizaj ka mbajtur, njëmbëdhjetë (11) mbledhje të rregullta dhe një (1) mbledhje të jashtëzakonshme dhe ate si datat në vijim:

1. Mbledhje e rregullt e Bordit të Drejtorëve, mbajtur më datë 04.02.2022
2. Mbledhje e jashtëzakonshme e Bordit të Drejtorëve, mbajtur më datë 28.02.2022
3. Mbledhje e rregullt e Bordit të Drejtorëve, mbajtur më datë 22.03.2022
4. Mbledhje e rregullt e Bordit të Drejtorëve, mbajtur më datë 30.03.2022
5. Mbledhje e rregullt e Bordit të Drejtorëve, mbajtur më datë 04.04.2022
6. Mbledhje e rregullt e Bordit të Drejtorëve, mbajtur më datë 16.05.2022
7. Mbledhje e rregullt e Bordit të Drejtorëve, mbajtur më datë 26.06.2022
8. Mbledhje e rregullt e Bordit të Drejtorëve, mbajtur më datë 27.07.2022
9. Mbledhje e rregullt e Bordit të Drejtorëve, mbajtur më datë 30.08.2022
10. Mbledhje e rregullt e Bordit të Drejtorëve, mbajtur më datë 31.10.2022
11. Mbledhje e rregullt e Bordit të Drejtorëve, mbajtur më datë 30.11.2022
12. Mbledhje e rregullt e Bordit të Drejtorëve, mbajtur më datë 21.12.2022

7.4 MBLEDHJET E ANËTARËVE TË KOMISIONEVE KOMUNALE TË KRM “PASTËRTIA”SH.A

Gjatë vitit 2022, Anëtarët e Komisioneve Komunale me Bordin e Drejtorëve dhe Ekzekutivin e KRM “Pastërtia” Sh.A Ferizaj ka mbajtur, një (1) mbledhje të rregullt në datën në vijim:

1. Mbledhja e përgjithshme e Anëtarëve të Komisioneve Komunale me Bordi e Drejtorëve, të KRM “Pastërtia” Sh.A Ferizaj, mbajtur më datë 04.07.2022